

Përmirësimi i procesit të identifikimit dhe regjistrimit të migracionit të përzier në Maqedoninë e Veriut**Duration:** 25.11.2024 - 24.11.2028**Countries:**
North Macedonia**EU contribution:** € 10 000 000**Total budget:** € 10 000 000**Implementer:**
INTERNATIONAL ORGANIZATION FOR MIGRATION**Website(s):** north-macedonia.iom.int/projects**Project description:**

Përmes projektit “Vendosja dhe përmirësimi i procesit të identifikimit dhe regjistrimit të migracionit të përzier në Maqedoninë e Veriut”, i financuar nga Bashkimi Evropian, BE-ja mbështet përpjekjet e Maqedonisë së Veriut për të forcuar sigurinë e kufijve të saj dhe për t'u përshtatur me standardet evropiane. Iniciativa përqendrohet në forcimin e infrastrukturës për menaxhim të kufijve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të migrantëve në përputhje me standardet e BE-së. Projekti zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Brendshme të Maqedonisë së Veriut. Këto janë objektivat gjatë periudhës katërvjeçare të zbatimit:

- Përmirësimi i sigurisë së përgjithshme në Maqedoninë e Veriut: Forcimi i sistemit për menaxhim të kufijve për të përmirësuar sigurinë e përgjithshme në vend;
- Rritja e sigurisë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut: Ngritja e një sistemi identifikimi dhe regjistrimi në përputhje me standardet e BE-së, i cili do të mundësojë identifikimin e saktë të personave, do të zvogëlojë rrezikun nga kontrabanda me migrantë dhe do të përmirësojë sigurinë e migrantëve dhe të popullsisë vendase;
- Qasje më e lehtë në mbrojtjen e kategorive të cënuara: Sigurimi i qasjes më të mirë në mekanizmat e mbrojtjes për grupet e cënuara;
- Ndërtimi i kapaciteteve të policisë kufitare: Zhvillim i trajnimeve për policinë kufitare, me qëllim nxitjen e ndjeshmërisë ndaj çështjeve që lidhen me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Expected results:

Projekti do të forcojë kapacitetin teknologjik të Maqedonisë së Veriut për identifikimin, regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të migrantëve dhe refugjatëve, në përputhje me standardet e BE-së. Përveç kësaj, do të ndihmojë institucionet shtetërore të përmirësojnë sistemin e IT-së për migracion dhe të sigurojnë funksionimin e tij të qetë dhe efikas në të gjitha autoritetet kompetente.